

Milenko Karan

## ASPEKTET SOCIOLOGJIKE DHE PSIKOLOGJIKE TË STUDIMIT ETNOLOGJIK TË GJAKMARRJES NË BALLKANIN QENDROR

### Motivi dhe qëllimi i punimit

Si shkas i drejtpërdrejtë për këtë punim është fillimi i studimit të gjakmarrjes në Kosovë.<sup>1</sup> Ata që për këtë dukuri dinë vetëm nga tregimet e romansuara mbi vendetën korzikane ose omertën siciliane mund t'i habisë fakti se ajo ende nuk është zhdukur në Jugosllavi. Më prezente është në Krahinën e Kosovës, kryesisht te banorët e kombësisë shqiptare. Është pritur që kjo mbeturirë e vetëgjyqësisë së mëparshme të zhduket në procesin e ndryshimeve shoqërore në vendin tonë. Mirëpo, nuk ndodhi kështu, ndonëse në vitin e fundit numri i veprave penale të gjakmarrjes është zvogëluar. „Kokëfortësia” kaq e madhe e gjakmarrjes, përveç intervenimeve përkatëse shoqërore, kërkon edhe kërkime shkencore, sepse „pjesët” e shumta të kësaj dukurie akoma nuk janë studjuar në një mënyrë të kënaqshme. Këto zbrastësi janë më evidente në „pjesën” e saj sociologjike dhe psikologjike. Studimi në fjalë ka karakter interdishiular. Duket se gjashtë „pjesët” që vijojnë, ose të themi më mirë, gjashtë qasjet pasuese të kësaj dukurie na premtojnë më shumë. Këto janë: qasja historike, juridike, etnologjike, sociologjike, psikologjike dhe psikiatrike. Lista e parashtruar këtu nuk është një ranglistë e këtyre shkencave sipas rëndësisë, por radhitje e natyrshme e tyre. Qëllimi i fundit i këtij studimi është përpilimi i një programi përkatës për luftimin e gjakmarrjes, gjë që, së bashku me komentin global, është detyrë më ambicioze e tij.

Në studimin e gjertanishëm të gjakmarrjes në Ballkanin qendror më së shumti lëndë na ka dhënë etnologjia. Në shkencën tonë ende nuk është vlerësuar si duhet ky kontribut. Për më tepër, ekziston aty-këtu një nënçmim i caktuar i këtij kontributi. Vërejtja që bëhet më shpesh është se kjo lëndë është fare pak shkencore. Nga kjo distancë, u muar vesh, mund t'i bëhet një vëtejje e këtyre kontributit në fjalë. Mirëpo, as këtu nuk duhet tepruar: me mundësitë e veta të atëhershme etnologjia jonë ishte shkencore — me disa punime të

<sup>1</sup> Bartës i hulumtimeve është Enti i Gjurmimeve Shoqërore pranë Fakultetit Juridik të Prishtinës. Financuese e gjurmimeve është Bashkësia Krahinore e Punës Shkencore.

veta me siguri mu në krye të shkencës evropiane të asaj kohe. Prandaj ekziston presupozimi legjitim se në visarin etnologjik mbi gjakmarrjen gjendet një dokumentacion i rëndësishëm sociologjik dhe psikologjik. Njësoj është, pra, legjitim edhe qëllimi që kjo lëndë të „testohet” me mjetet e sociologjisë e të psikologjisë bashkëkohore. Ky është, në pika më të shkurta, qëllimi i këtij punimi, ndonëse, por me ambicje të tjera, mund të kërkohet edhe një „testim” i caktuar etnologjik i të dhënave të fituara ose të presupozuara sociologjike dhe psikologjike që i referohen kësaj mbeturire për shumë gjëra interesante të sjelljes juridike-zakonore të njerëzve në Ballkanin qendror.

### Diçka për gjakmarrjen në përgjithësi

Si ishte gjakmarrja në kohën më të vjetër — nuk dihet me siguri, por me një analizë të shëndoshë të periudhës së mëparshme mund të pohojmë se ajo ishte mizore dhe pa kufizime. Na merr mendja se shprehja „absolutizëm” është karakteristikë më e saktë e atyre ditëve dhe e kësaj sjelljeje në to. Njerëzit e mençur e panë shpejtë absurditetin e kësaj sjelljeje dhe mu për këtë kufizimet e gjakmarrjes u shfaqën relativisht heret. Ndër kufizimet e para është ai i shënuar në Kodin e Hamurabit, i cili gjakmarrjen e përcakton sipas parimit të talioneve.<sup>2</sup> Këtë parim e përcakton edhe Kodi romak i XII tabelave,<sup>3</sup> por edhe Drejtësia ruse.<sup>4</sup> Ndër shqiptarët ai është formuar në rregullën „Kokë për kokë”. Kufizimi i dytë është vendosja e dëmshpërblimit (në të holla ose në sende), gjë të cilën e vë në dukje edhe shprehja „vrazhda” — si quhej ndër sllavët e jugut gjoba për vrasje. Kufizim i tretë është zvogëlimi i numrit të personave që merreshin parasysh për hakmarrje. Me kohë ky numër u kufizua në anëtarët meshkuj të familjes (të gjerë dhe të ngushtë). Në këtë kufizim bën pjesë edhe përjashtimi nga gjakmarrja i grave, priftërve,<sup>5</sup> pleqve<sup>6</sup> dhe, si rrugull i përgjithshëm, i fëmijëve.<sup>7</sup> Kufizimi i katërt i gjakmarrjes është pajtimi i palëve në grindje që konfliktet të zgjidhen me një arbitrazh të caktuar shoqëror. Vendimet merreshin nga i ashtuquajtimi këshill i pleqve. Ndër sllavët ata quheshin „dushevnic” (sepse gjykonin „sipas shpirtit”, dmth. sipas ndërgjegjes), kurse ndër shqiptarët ata quhen „pleqnarë”. Vendimit të tyre nuk mund t’i bëhej vërejtje, që do të thotë se obligimi i respektimit të tij ishte pa kushte.<sup>8</sup>

Gjakmarrja është shprehje e një rregullore të caktuar të sjelljeve parashetërore. Kjo rregullore u përcatua në kuadër të fiseve, për ç’shkak V. Bogishiq konkludoi me të drejtë se „aty ku ka fis ka edhe gjakmarrje”. Për më tepër

<sup>2</sup> Neni 196 i Kodit të Hamurabit thotë: „Në qoftë se dikush ia nxjerr syrin njeriut të lirë, do t’i nxirret edhe atij”.

<sup>3</sup> Ligji i XII tabelave përcakton: „Kush ia thyen tjetrit ndonjë gjymtyrë dhe nuk merret vesh me të, edhe ai le t’ia bëjë të njëjtën gjë”.

<sup>4</sup> Drejtësia ruse në nenin e parë (pikërisht në inicial) përcakton: „Nëse njeriu vret njeriun, atëherë hakmirret vëllai për vëllanë, ose i ati ose i biri ose djali i vëllait ose djali i motrës”.

<sup>5</sup> „Me granit të dorërasit s’ka punë shpija e të vramit, sepse Grueja e Prifti nuk biejn në gjak” S h t. G j e ç o v, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Shkodër 1933, § 897. Reprint Prishtinë 1973. Këtë botim e ka përcjellë me studimin e vet Dr. S. P u p o v c i.

<sup>6</sup> Sipas të ashtuquajturit *Kod i Skenderbeut* hakmarrja nuk mund të bëhej kundër njeriut që ka lënë armën dhe ka marrë shkopin, do të thotë kundër plakut.

<sup>7</sup> Përjashtimi i fëmijëve nga hakmarrja nuk ishte i detyrueshëm. Sipas këtij Kodi djali, ndonëse në djep, i nënshtrohet hakmarrjes, por vrasja e fëmijëve ishte gjë shumë e rrallë.

<sup>8</sup> „Plak mbi Plak, gjyq mbi gjyq e bë mbi bë kanëja nuk bán” S h t. G j e ç o v i, *KLD* § 1002.

me një numër mjaft të madh faktesh provohet se të gjitha ligjet e përmendura janë pjesërisht kodifikim përkatës i të drejtave zakonore të genseve dhe të fiseve. Kështu pohohet edhe për Kodin e Dushanit. Rezistencën e ngultë të së drejtës zakonore që t'i nënshtrohet së drejtës shtetërore e diktoi qysh në kohën e vet V. Bogishiq, por po këtë gjë e vërejtë edhe V. S. Karaxhiq<sup>9</sup> dhe një numër i madh përkrahësish të jetës popullore të asaj kohe.<sup>10</sup> Gjakmarrja nuk është e drejtë penale me kuptimin real të kësaj fjale, sepse kjo e drejtë presupozonte ekzistimin e një pushteti të organizuar shtetëror që është mjaft i fortë që të mund t'i përcaktojë dhe t'i zbatojë vetë dënimet për kundërvajtje të caktuara. Mirëpo, krimet kanë ekzistuar edhe para lindjes së shtetit. Sanksionet përcaktoheshin nga organizatat shoqërore që i paraprinë rregullimit shtetëror. Këto ishin bashkësi të bazuara në gjini gjaku. Gjakmarrja, pra, është manifestim më i qartë i solidaritetit primar (një për të gjithë, të gjithë për një). Në rrethanat e njohura të kësaj periudhe dy vlera ishin posaqërisht të rrezikuara: pasuria dhe jeta. Gjakmarrja është mbrojtje e këtyre vlerave, por edhe paralajmërim i padyshimtë i sulmuesit se pas sulmuesit fshihet familja e tij, vëllazëria dhe fisi i tij mu sikurse gjakmarrja i kërcënohet jo vetëm sulmuesit, por edhe familjes, vëllazërisë dhe fisit të tij. Domosdoshmëria e kësaj sjelljeje për njerëzit e ditëve tona duket jo e zakonshme. Në kohën për të cilën e kemi fjalën ajo kishte kuptim të plotë, sepse siguronte unitetin e grupit dhe, sidomos, sistemin e tij të vlerave, gjë që ishte një garanci e mjaftueshme për sentimentin e sigurisë së çdo anëtarit të tij. Nga kjo distancë e kohës ky regjim i sjelljes, u muar vesh, ishte i vrazhdët, por në rrethanat e atëhershme të jetës, me gjasë, vetëm ai ka mundur të ekzistojë.<sup>11</sup> Kjo do të thotë se ka qenë legjitim, që vërtetohet edhe nga dokumentacioni përkatës mbi gjakmarrjen në këtë trevë.

### Dokumentet mbi gjakmarrjen në këtë trevë

Dokumenti i parë i shkruar mbi gjakmarrjen ndër sllavët e jugut është shënuar në Strategikon (XI,5),<sup>12</sup> që i atribuohet mbretit Mavrik. Për kohën nga ky dokument deri në ardhjen e turqve në këto vise ka fare pak të dhëna kështu që supozohet se shtetet ballkanike të mesjetës shkatërruan mënyrën fisnore të jetës e së këndejmi edhe gjakmarrjen. Si dëshmi përmendet më shpesh Kodi i Dushanit në të cilin nuk ka as gjurma të së drejtës zakonore. Se kjo e drejtë në këto vise nuk ia lëshonte lehtë vendin së drejtës shtetërore tregon edhe ekzistimi i gjakmarrjes në Bosnje.<sup>13</sup> Atë e shënon edhe M. Orbini,<sup>14</sup> por edhe tekstet e gurëve të varreve mesjetare — përmendoreve të njohura mesjetare të Bosnjes e të Hercegovinës.<sup>15</sup> Zakonisht konsiderohet se shtetet tona mesjetare

<sup>9</sup> Vuk Stefan Karadžić, *Crna Gora i Boka Kotorska*, Nolit, Beograd 1972.

<sup>10</sup> Kështu një informues i V. Bogishiqit shkruan „Sot vetë shqiptarët thonë: të gjithë duam të na gjykojnë ashtu si ka thënë Leka e jo të tjerët”. Sipas Dr. B. Nedelkoviçit, *Kaunun Leke Dukagjinitja, Arbanaško običajno pravo. Iz rukopisne zaostavštine Valtazara Bogišića*, Anali Pravnog fakulteta u Beogradu, Beograd 1976, nr. 4, f. 438.

<sup>11</sup> S. Vukosavljević, *Organizacija dinarskih plemena*, Srpska akademija nauka, Botl me të veçanta, libri CCCXX, Etnografski institut libri 7, Beograd 1957, f. 75.

<sup>12</sup> Dr. K. Kadlec, *Prvobitno slovensko pravo pre X veka* Geca Kon, Beograd, 1924, f. 93.

<sup>13</sup> Dr. V. Čučković, *Krvna osveta u srednjevekovnom bosanskom pravu*, Godišnjak Pravnog fakulteta u Sarajevu, Sarajevo 1971, f. 264.

<sup>14</sup> M. Orbini, *Kraljevstvo Slovena*, Srpska književna zadruga, Beograd 1968, f. 177.

<sup>15</sup> S. Bešliagić, *Stećci centralne Bosne*, Zavod za zaštitu spomenika kulture BiH, Sarajevo 1967, f. 98.

qysh para ardhjes së turqve në këto treva, përcaktuan pushtetin e vet (shtetëror) qendror dhe në këtë mënyrë zhdukën vetëgjyqësinë, e me këtë edhe gjakmarrjen. Sipas këtij botëkuptimi mënyra fisnore e jetës, në një mënyrë akoma të pashpjeguar, u përtri me ardhjen e turqve — sidomos në Shqipërinë e Veriut dhe në Mal të Zi. Mirëpo, historianët e tjerë konsiderojnë se mënyra fisnore e jetës kurrë nuk është zhdukur deri në fund, porse „e heshtur” për një kohë vetëm ka vazhduar të ekzistojë edhe pas ardhjes së turqve, gjë që provohet me tolerancën e njohur të autoriteteve të pushtetit turk së drejtës zakonore në viset që i pushtonin ata. Këtë qëndrueshmëri të së drejtës zakonore e shënojnë, në mënyrë gati dramatike, mesazhet e njohura të Petrit I, i cili madje edhe vdekjen e vet e shfrytëzoi për t’i pajtuar fiset, kështu që në popull mbeti si „i shenjtë”. Këtë qëndrueshmëri e vërtetojnë në mënyrë edhe më të dukshme kryengritjet kundër vënies së tatimeve në Mal të Zi. Gjurma të caktuara, vetëm se në një formë të ndryshuar, të këtij organizimi fisnor ka edhe sot: ato identifikohen në të ashtuquajturat klube të vendlindjes nëpër qytete të mëdha ose në grindjet që akoma ekzistojnë midis fiseve në jetën e përditshme. Ndryshe nga historianët, etnologët më pak janë marrë me shkaqet, e më tepër me format e gjakmarrjes në këtë trevë, respektivisht me përshkrimin sa më të saktë të saj.

E drejta zakonore e sllavëve të jugut, me përjashtim të Statutit të Gërbalit dhe Ligjit të Vasojeviqëve prej dymbëdhjetë pikash, nuk ka lënë rregulla të mbarështruara të sjelljes zakonore. E drejta zakonore shqiptare është më e pasur në këtë dokumentacion. Kjo e drejtë është më e vjetër se Lekë (III) Dukagjini me emrin e të cilit lidhet më shpesh lindja e Kanunit, i cili shekuj me radhë rregulloi marrëdhëniet dhe jetën e fiseve të Shqipërisë së Veriut, kryesisht të fiseve të blegtorëve. Kur dhe si u nxor ky Kanun — pak dihet. Dokumente të shkruara nuk ka, kështu që në shkencë u aprovua mendimi se ky kanun nuk ka qenë i shkruajtur fare, por është përcjellë gojë pas goje prej një gjenerate në tjetrën. Emrin e mori sipas Lekës, që ishte një luftëtar i njohur kundër turqve, dhe, me gjasë, pleqnar i dalluar. Në traditën popullore, u muar vesh, ka më shumë të dhëna, por këto janë të pasigurta — sikurse në të gjitha veprat si këto. Ekzistojnë disa versione të këtij kanuni. Versionin më të vjetër e botuan turqit në vitin 1871 për t’i detyruar shqiptarët që të respektonin shëriatin, sepse ky është „shprehje e qytetërimit”.<sup>16</sup> Studimi shkencor i këtij kanuni fillon me V. Bogishiqin dhe me ardhjen e tij në Mal të Zi në vitin 1973. Në këtë punë ai që në fillim hasi në këtë kanun, i cili menjëherë ia tërhoqi vëmendjen, meqë ai supozonte me arsye se në të fshiheshin përgjegjet e shumë pyetjeve për shkak të të cilave kishte ardhur nga Rusia e largët. Në vitin 1901 R. Kosmajac botoi „Leka Kanun-in”<sup>17</sup> e tij, e mu në pragun e Luftës ballkanike (në vitin 1912) pushteti turk përgatiti Projektin e ligjit mbi kodifikimin e së drejtës zakonore shqiptare, që përfshiu edhe Kanunin e Lekë Dukagjinit. Ky ligj nuk hyri në fuqi, sepse lufta çlirimtare e popujve të Ballkanit i përzu turqit dhe eliminoi qëllimin e tyre. Përmbledhja më e plotë dhe më e mirë e këtij kanuni është ajo e botuar nga Sht. Gjeçovi.<sup>18</sup> Kjo përmbledhje përmban 1263

<sup>16</sup> Dr. S. Pupoçi, *Gradjanskopravni odnosi u Zakoniku Leke Dukagjinita*, Zajednica naučnih ustanova Kosova i Metohije, Prishtinë, 1958, libri 5.

<sup>17</sup> Dr. S. Pupoçi, *Krvna osveta u Albanaca i njen razvoj*, Jugoslovenska revija za kriminologiju i krivično pravo, Beograd 1971, nr. 4.

<sup>18</sup> Sht. Gjeçovi, *op. cit.*

paragrafe. Ajo konsiderohet si më autentike, ndonëse, si edhe të gjitha të tjerat, ka të meta të caktuara që i kushtëzoi edhe profesioni i tij — Gjeçovi ishte prift dhe mu për këtë në përmbledhjen e tij ai theksoi veçanërisht rëndësinë, të drejtën dhe mbrojtjen e kishës — u muar vesh katolike.

### Aspektet sociologjike dhe psikologjike në studimin e gjertanishëm etnologjik të gjakmarrjes në Ballkanin qendror

Në studimin e gjertanishëm të gjakmarrjes ekzistojnë diferenca të mëdha. Në literaturën përkatëse ka më shumë punime etnologjike dhe historike, e pastaj juridike. Shumë më pak ka punime sociologjike dhe, sidomos, psikologjike, ndërsa punime psikiatrike lidhur me këtë dukuri nuk ka, ndonëse ekzistojnë disa iniciativa për punime të këtilla.<sup>19</sup> Është gjë e natyrshme që punime etnologjike ka më shumë, sepse vetëm emri i etnologjisë tregon se ajo është e orientuar në këtë studim. Me arsye të ngjashme mund të shpjegohet prania e konsiderueshme e historisë në studimin e gjakmarrjes, gjë që nuk mund të thuhej edhe për të drejtën, meqë prapavija e pranisë së saj këtu është pasojë e faktit se me gjakmarrjen më shumë punë kishin autoritetet e pushtetit — nga rrjedh interesimi i tyre për këtë dukuri. Punimet „thjesht” sociologjike mbi gjakmarrjen fillojnë me Dr. M. Shuflajin-in.<sup>20</sup> Nga ato më të rejat duhet dalluar punimin e Dr. H. Hoxhës, i cili, me gjithë të metat e caktuara, është punim i parë „i vërtetë” sociologjik mbi gjakmarrjen ndër ne.<sup>21</sup> Punime psikologjike mbi këtë dukuri ka diçka më shumë, por ato janë kryesisht shqyrtime të kësaj dukurie të bazuara në presupozime, që do të thotë se u mungon materiali empirik dhe dokumentacioni.

Fakti se në studimin e gjertanishëm të gjakmarrjes ka pak punime sociologjike dhe psikologjike nuk do të thotë se në studimin e kësaj dukurie nuk ka shpjegime sociologjike dhe psikologjike. Këto shpjegime fillojnë që me V. S. Karaxhiqin, i cili me mjaft arsye mund të konsiderohet iniciator i parë i sociologjisë së gjakmarrjes ndër ne. Shumë më tepër dokumentacion të këtij lloji ka në punimin e V. Bogishiqit dhe në përpjekjet e tij për prezencën e sociologjisë e të psikologjisë në studimin e së drejtës zakonore. Kontribut të rëndësishëm për përcaktimin e veçorive shoqërore të gjakmarrjes dha J. Cvijiqi<sup>22</sup> dhe, sidomos, shkolla e tij, por edhe M. Milani<sup>23</sup> dhe S. Duçiqi<sup>24</sup> — që të dy autodidaktë dhe jo mjeshtër të pendës. Nga gjurmuesit më të rinj nuk mund të mos përmenden S. Vukosavljeviq,<sup>25</sup> Dr. V. Çubrilloviq,<sup>26</sup> Dr. M. Bajrak-

<sup>19</sup> M. Karan, *Krvna osveta i mesto psihijatrije u proučavanju te pojave*, Neuropsihijatrija, vol 20, Zagreb 1972, nr. 3—4.

<sup>20</sup> M. Sufflay, *Povijest sjevernih Arbanasa*, Studim sociologjik. Arhiv za arbanasku starinu, jezik e etnologiju, Libri II, Beograd 1925.

<sup>21</sup> Dr. H. Hoxha, *Neke sociološke karakteristike, društveni uzroci i posledice krvne osvete kod albanske nacionalnosti u Jugoslaviji*, Jugoslovenska revija za kriminologiju i krivično pravo, Beograd 1971, nr. 4.

<sup>22</sup> J. Cvijić, *Balkansko poluostrvo i južnoslovenske zemlje*, Zavod za izdavanje udžbenika SR Srbije Beograd 1966.

<sup>23</sup> M. Milanov, *Sabrana dela*, Grafički zavod, Titograd 1967.

<sup>24</sup> S. Dučić, *Zivot i obiçaji Kuća*, Srpska Kraljevska Akademija, Srpski etnografski zbornik, libri XLVIII, Beograd 1931.

<sup>25</sup> S. Vukosavljević, *op. cit.*

<sup>26</sup> Dr. V. Čubrillović *Postanak plemena Kuća*, Beogradski universitet, Zbornik Filozofskog fakulteta, libri VII-1, Përkujtimorja e Viktor Novakut, Beograd 1963.

taroviq<sup>27</sup> dhe Dr. M. Krasniqi. Dokumentacionin sociologjik dhe psikologjik ka edhe në punimet e juristëve tonë: Dr. I. Jeliq, <sup>28</sup> Dr. B. Ndelkoviq <sup>29</sup> dhe Dr. S. Pupovci.<sup>30</sup> Të gjithë këta, me diferenca të kuptueshme, komentojnë gjakmarrjen me një fjalor në esencë sociologjik dhe në mënyrën sociologjike të mendimit.

Për shkak të kontributit të përmendur dija etnologjike mbi gjakmarrjen në Ballkanin qendror është dokumentacion i pashmangshëm për përcaktimin e aspekteve sociologjike dhe psikologjike të kësaj dukurie. Me rastin e zgjedhjes së këtij dokumentacioni, për nevojat e këtij punimi, më pak kemi përfillur „titullin” e autorit e më shumë cilësitë e vërteta të punimit të tij. I. Jeliq ka qenë jurist, por pjesë të tëra të studimit të tij, përshkrimi i pajtimit të gjakut, bie fjala, janë tekst thjesht etnologjik. Ndër mundësitë e shumta na u desh të zgjedhnim çështjet, të cilat, më parë se të tjerat, mund të ishin objekt komenti përkatës. Çështjet e zgjedhura janë vetëm një pjesë e tyre, padyshim të gjitha nuk janë as çështje më të rëndësishme, por këto që parashtrohen këtu kryesisht sigurojnë komentin e planifikuar. Ky punim, pra, është kontribut në përpjekjet për studimin bashkëkohor të gjakmarrjes në Ballkanin qendror — kësaj here vetëm në kuadër dhe me mjetet e psikologjisë etnologjike (dhe të sociologjisë etnologjike gjithashtu).

### Fisi dhe normat e sjelljes së tij

Si dhe pse lindën fiset është çështje që edhe sot e kësaj dite shtron enigma para shkencës. Fisi zakonisht karakterizohet si një grup familjesh, respektivisht vëllazërisht i bazuar në gjininë e gjakut. Armaturën psikologjike të kësaj bashkëjetese e përbën tradita për stërgjyshin (prejardhjen) e përbashkët dhe kufijt e përcaktuar saktësisht të territorit të fisit. Në rrethana mjaft të precizuara hapësirore, ekonomike dhe shoqërore të jetës së vet çdo fis përcaktonte rregulloren e vet të sjelljes. Cilësia më e dukshme e kësaj rregulloreje është nënshtrimi i individit para grupit. Kjo domosdoshmëri e rregullave të sjelljes është garanci e caktuar e unitetit të grupit, por edhe garanci për çdo anëtar të tij se do të gëzojë mbrojtjen. Mu për këtë shoqëria fisnore pothuajse nuk di për konflikte midis gjeneratave ose për të ashtuquajturat raste sociale. Gruaja, vërtetë, nuk kishte të drejta,<sup>31</sup> por nuk ishte e nënçmuar. Me një rregullore të këtillë të sjelljes fisi i siguronte çdo anëtar të tij plotësimin e nevojave themelore (banesën, ushqimin, mbrojtjen e pasurisë e të jetës), duke përfshirë këtu sidomos mundësinë e plotësimit të nevojës për vetaktualizim (A. H. Maslov — A. H. Maslow), dmth. për zhvillimin e papenguar të aftësive të veta krijuese, sidomos të atyre që në këtë ambient çmoheshin posaçërisht (trimëria, urtia, burrëria). Për shkak të sistemit të këtillë të vlerave në fis çmoheshin pak zejtarët dhe tregtarët, kurse njeriu anonim pothuajse aspak — të tillët quhe-

<sup>27</sup> Dr. M. Barjaktarević, *Plemensko uredjenje kod Albanaca*, nga: *Iz istorije albana- ca*, Zavod za izdavanje udžbenika SR Srbije, Beograd 1969.

<sup>28</sup> Dr. I. Jelić, *Krvna osveta i umir u Crnoj Gori i severnoj Albaniji*, Beograd 1927.

<sup>29</sup> Dr. B. Nedeljković, *op. cit.*

<sup>30</sup> Dr. S. Pupovci, *op. cit.*

<sup>31</sup> „(Poronikë) s’do jenë grá, ’se kanúja s’i xën”. Sht. Gjeçov, *KLD*, § 1045.

shin „askushi”. Në prapavijën e kësaj sjelljeje padyshim fshihet dinamizmi i identifikimit, por kjo nuk do të thotë se fisi krijonte personalitete „konfeksioni”. Mu ky ambient kultivonte dhe jepte nxitje për gara dhe sidomos u thurte lavde individëve që ngriteshin mbi atë që ne sot e quajmë mesatare. Kjo është karakteristikë e veçantë psikologjike e mënyrës fisnore të jetës.

### Formimi i sistemit të caktuar të vlerave

Në vlerësimin psikologjik dhe në atë sociologjik gjithashtu këto gara janë përgjegje e shumë enigmave të sistemit të vlerave të fisit. Këto gara nuk janë për shkak të motiveve që i përmend K. Horni (K. Horney) për shoqërinë bashkëkohore të Perëndimit, e cila lejon me simpati çdo veprim që bën një individ që të korrë suksesin aq të çmuar në atë shoqëri. Këto gara nuk krijojnë as përbindësh shoqërorë për të cilët flet E. From (E. Fromm) në analizën e tij të personalitetit autoritar të botës bashkëkohore. Njeriu i fisit me të vërtetë ishte i lirë: kur princ Nikolla e nguci një malazez, duke i thënë se populli nuk e donte gër kapiten, ky me gjuhën e tij shpatë ia ktheu: As ty si sundimtar — vetëm po të guxonte! Në një kësi ambienti të jesh trim nuk do të thotë të jesh cub, por personalitet me një sistem komplet vlerash, ku fare pak rëndësi kishte pasuria ose prejardhja: për të fituar një prestigj të caktuar secili duhej të tregonte veten. Në këtë sistem vlerash dy vlera ishin të paprekura. Këto janë mikpritja dhe besa. Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit shtëpia shqiptare i takon zotit dhe mysafirit, prandaj vrasja e mysafirit është krim që, pa përjashtim, dënohej me vdekje.<sup>32</sup> Besa (nga folja „besoj”) ndër shqiptarët është fjala e dhënë se diçka do të bëhet ose do të hiqet dorë nga ndonjëgjë. Ajo është e ngjashme, por nuk është e njëjtë me atë që malazezët e quanin „vjera”, „tvrda vjera”. Shkelja e besës është krim. Fjala e dhënë duhej mbajtur — shpeshherë duke rrezikuar edhe kokën.<sup>33</sup> Besa e shkelur patjetër sjell „leçitjen” (bojkotimin) nga ana e të gjithë anëtarëve të grupit, gjë që në rrethana të atëhershme ishte dënim pothuajse i barabartë me dënimin me vdekje — sot një sanksion i këtitillë do të quhej „vdekje civile”. Normat e përmendura të sjelljes tregojnë se si një sistem i caktuar i vlerave reflektohet në çiftin individ — grupi, por ato nuk shpjegojnë pse ky sistem i vlerave reflektohet kështu.

### Individi dhe grupi referues i tij

Në psikologjinë bashkëkohore, sidomos në psikologjinë sociale, motivacioni i sjelljes së individëve kërkohet në kuadër të grupeve referuese të tyre (D. Kreç dhe R. S. Kraçfild — D. Krech dhe R. S. Crutchfield). Si grup referues shënohet çdo grup të cilit dikush i takon ose dëshiron t'i takojë, me të

<sup>32</sup> Vrasësi mund të falet në qoftë se të ka vrrarë babën, vëllain, birin ose madje edhe tërë familjen, por për vrasjen e mysafirit gjaku nuk mund të falet (sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit).

<sup>33</sup> Për besën shih: Dr. M. Krasniqi, *O besa — prilog proučavanju običajnog prava kod Siptara*, Jugoslavenska akademija znanosti i umjetnosti, Zagreb 1962. Po kështu te: H. Ismaili, *Besa u običajnom pravu Albanaca*, Institutit Albanologjik, i Prishtinës Gjurmime Albanologjike — folklor dhe etnologji, I, Prishtinë 1971. Po kështu te: M. Karan, *Psihološke odlike bese*, Psihologija, Beograd 1974, nr. 1

cilin identifikohet në të vërtetë, sepse në këtë mënyrë krijon mundësi për t'i plotësuar nevojat e veta dhe për të fituar një prestigj të caktuar. Pikënisja teorike e këtij shpjegimi është fakti se askush nuk jeton „në shoqërinë në përgjithësi”, por në një „pjesë” të saj të përcaktuar me përpikmëri. Fisi dhe mënyra e jetës së tij është shembull i ndikimit të grupit referues në sjelljen e individëve. Njeriu i atëhershëm pothuajse tërë jetën e tij e kalonte në një grup të njëjtë. Prandaj për të kishte rëndësi të veçantë se si e pranonte grupi dhe ç'mendonte për të. Mu për këtë ruhej që të mos i shkelte normat e sjelljes së grupit. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se sjellja e tij ishte refleks kondicional dhe pa kurrfarë autonomie sa i përket zgjedhjes. Po të kishte ndodhur kështu, atëherë do të ishte e pamundur që të formohej sistemi i vlerave, sepse ky presupozon jo vetëm nënshtrimin, por edhe përsosjen e tij. Këtë përsosje nuk ka mundur ta bënte grupi, si grup në përgjithësi, por vetëm individët që dalloheshin nga „mesatarja”. Shembulli i Lekë Dukagjinit në Shqipëri dhe i Mark Milanit në Mal të Zi e vërteton këtë gjë. Këta njerëz nuk u bënë legjendë për shkak se ishin „të ndëgjueshëm”, por ngase i shtuan shumë gjëra të reja sistemit të vlerave të rrethit shoqëror të tyre. Kësodore edhe këtu konfirmohet konkluzioni i psikologjisë bashkëkohore se shoqëria krijon njeriun, porse edhe ky e krijon atë. Në shoqërinë fisnore këto gjëra të reja nuk mundën t'i sillnin vetëm individët e dalluar, dmth. personat që rrethin e vet „e befasuan” me ndonjë sjellje të papritur. Në këngën popullore shqiptare ende këndohet për trimërinë e një nëne, e cila në ditën e martesës së të birit luan dhe thërret vazhdimisht mysafirët që të luajnë dhe ata, ndonëse i biri ishte vrarë mu në ditën e dasmës, për çka mysafirët, u muar vesh, nuk dinin fare. Shembulli i gjakmarrjes tregon më së miri këtë sistem të vlerave. Gjakmarrja pranohej si procedurë e zakonshme. Ajo lejohej, po këta njerëz kurrë nuk janë entuziazmuar përnjëmend me të. Ndërkaq, këtë e bënin kur ndokush falte gjakun, sepse konsiderohej me të drejtë se hakmarrje mund të bëjë çdo i marrë, porse gjakun mund ta falë vetëm një pronalitet i pjekur dhe i sigurtë. Mu kjo në Mal të Zi quhet „burrëri” në sjellje. Burrëria është guxim plus edhe „diçka”. Kjo është mençuria, fisnikëria, drejtësia dhe mbi të gjitha fuqia që njeriu të frenojë veten.

Kjo marrëdhënie midis individit dhe grupit, sistemit të tij të vlerave, në të vërtetë shihet më shumë te gjakmarrja, gjë që mund të merret me mend, sepse ajo është veprim më dramatik i sjelljes së të drejtës zakonore në kuadër të fisit. Ajo është njëkohësisht shembull më i dukshëm i solidaritetit primar të anëtarëve të një grupi (fisi).

### **Gjakmarrja si solidaritet primar**

Si duket presupozimin më të mprehtë mbi origjinën e sjelljes solidare e dha S. Frojdi (S. Freud) me hipotezën e tij mbi hordhinë e parë dhe atvrasjen. S'ka dyshim se nevoja e detyroi njeriun që të bashkohet me tjetrin. Prapavijën e kësaj bashkëjetese e përbën solidariteti i anëtarëve të grupit, kurse prapa kësaj padyshim fshihet frika, respektivisht nevoja për të pasur një siguri. Nevojat nuk mund të plotësoheshin në kushte planetare, por vetëm në suaza të ngushta të jetës. Këto suaza mund të ishin vetëm grupi i njerëzve, bashkëjetesa e të cilëve bazohej në gjini gjaku. Gjakmarrja është shembull i këtij solidariteti,

ndonëse nuk është i vetmi. Në kohën e pasigurisë së përgjithshme dhe të mungesës së pushtetit qendror ajo është garanci konkrete e sigurisë personale dhe të përbashkët — të gjitha këto, u muar vesh, në kuadër të fisit. Drejtpeshimi ndër-fisnor vendosej në baza të ngjashme, kështu që sistemi i vlerave kishte një vlerë relative: vjedhja në fis ishte sjellje e pahijshme, por plaçkitja e fisit tjetër jo (sepse ata të tjerët nuk janë „tonët”). Kjo psikologji e fisit lehtë mund të njihet nga gjuha. Shprehja „fisnik” rrjedh nga fjala fis mu sikurse shprehja „nemas” tregon njeriun që është „nem” (memec), (që nuk di të flasë) ose shprehja „sloven” që tregon njeriun që di të flasë (sillovi) — do të thotë të vetin. Po këtë, sipas një shpjegimi, do të thotë edhe shprehja „shqiptar”, ajo tregon personin që „kupton gjuhën”, u muar vesh, gjuhën shqipe, që do të thotë se është fjala për njeriun „e vet”. Gjakmarrja është shprehje dhe pasojë e këtij solidariteti, që sjelljen e njerëzve e përcakton sipas parimit „sy për sy, dhëmb për dhëmb”, (ndër shqiptarët: kokë për kokë, gjaku për gjak). Si dukuri ajo pothuajse është zhdukur në botën bashkëkohore, por në disa vise ende jo. Nuk është lehtë të shpjegosh këtë gjë të çuditshme, por që tani dihet me siguri se mendimet, siq janë „gjaku i nxehtë” ose „agresioni i lindur” të njerëzve në fjalë nuk mund të jenë as presupozime aktive të shpjegimit të mudshëm. Si veprim individual, gjakmarrja është fakt psikologjik (dhe penal, natyrisht), por si dukuri ajo është realitet sociologjik. Prandaj, asnjë shqyrtim i kësaj dukurie nuk mund t’u shmanget rrethanave shoqërore që janë përgjegjëse për lindjen dhe ruajtjen e saj.

### „Rrethina” sociologjike e gjakmarrjes

Gjakmarrja është kureshtje e punëtorëve të shumë shkencave që janë orvatur të zbulojnë prapavijën e saj. Deri më tani kemi shumë shpjegime në këtë drejtim. Ato fillojnë me shpjegimin gjeografik, e mund të mbarojnë me atë psikoanalitik. Midis tyre ka shumë botëkuptime psikologjike dhe sociologjike që mund të shfrytëzohen për një qëllim të këtillë (G. Tard, E. Dirkem, S. Frojd — G. Tard, E. Durkheim, S. Freud). Mirëpo, asnjë prej tyre nuk mund të shpjegojë këtë dukuri pa lënë gjë mangut. Këtë nuk mund ta bëjë as metoda sociologjike që në mënyrë të thjeshtësuar përcakton se personaliteti është „efekt i thjeshtë social”. As shpjegimi „thjesht” psikologjik nuk ka shansë shumë të madhe për një ambicje të këtillë, sepse ai medoemos zvogëlon rëndësinë e rrethanave shoqërore të kësaj dukurie. Mu për këtë na duket i arsyeshëm presupozimi se për shpjegimin „e plotë” të gjakmarrjes më së shumti premtion metoda sociale-psikologjike.<sup>34</sup> Për një qëllim të këtillë duhet të përcaktohet pikënisja përkatëse teorike. Më së shumti na premtion prezenca e dy emrave: K. Marksit (K. Marx) dhe S. Frojdit (S. Freud). I dyti siguron dokumentacionin më të mirë për personalitetin, ndërsa i pari garanton këtë për suazat shoqërore të tij.<sup>35</sup> Si duket, dokumentacioni etnologjik mbi gjakmarrjen këtë mundësi e bën edhe më të besueshme. Ky dokumentacion vërteton presu-

<sup>34</sup> M. K a r a n, *Socijalnopsihološke pretpostavke prisustva krvne osvete u našim danima*, Revija za sociologiju, Zagreb, nr. 3—4.

<sup>35</sup> M. K a r a n, *Legitimnost prisustva psihologije u proučavanju krvne osvete*, Obeležje, Priština 1972, nr. 5.

pozimin e Mekdugalit (W. Mc Dougal) mbi instinktin gregar (vetë emri nuk është me rëndësi) si prapavijë të bashkëjetesës njerëzore. Ai gjithashtu vërteton formulën e Levinit (K. Lewin) se sjellja është „personaliteti plus ambienti”, gjë që nuk është pa rëndësi për këtë qëllim, sepse Levini, bashkë me Mekdugalin, është përfaqësues më i njohur i psikologjisë sociale në shpjegimin e sjelljes njerëzore. Për qëllimin e këtillë lënda etnologjike është dokumentacion i pashmangshëm: përshkrimet e zhdukjes së saj në Mal të Zi, bie fjala, tregojnë se për këtë zhdukje nuk kanë qenë me rëndësi vendimtare qëllimet e individëve, sado të ndershme (Petri I) ose të rrepta që të kenë qenë (Danillo II), por zhvillimi ekonomik e kulturor dhe, u muar vesh, forcimi i pushtetit shtetëror, që me logjikën e forcimit të vet shkatërronte të ashtuquajturin organizim fisnor.<sup>36</sup> Gjakkarrja që ende ekziston në Kosovë (Jugosllavi) mund të shpjegohet me arsye si këto. Kjo Krahinë është e njohur si trevë më e pazhvilluar e vendit. Një numër akoma i madh njerëzish të kësaj ane janë „natyralë” dhe të pashkolluar, me të ardhura të vogla dhe me pak mundësi për t’u inkuadruar në punë, të paushqyer sa duhet dhe shëndetligë, ku shumë linden, por edhe mjaft vdesin. Shembulli i kësaj treve konfirmon të vërtetën e kahershme se njerëzit nuk bëhen bashkëkohorë ngase kanë ligje bashkëkohore, por për arsye se kanë kushte bashkëkohore të jetesës. Këto kushte, në instancën e fundit, caktojnë qëndrimet e tyre dhe sistemin e tyre të vlerave, shkurt: determinojnë sjelljen e tyre.

### „Pjesët” psikologjike të gjakkarrjes

Bllazho Popoviq, gjë e papritur për ato vjet, shkruante se tregimet e Mark Milanit për shqiptarët „për kah esenca e tyre kanë karakter thjesht psikologjik”.<sup>37</sup> Një gjë të ngjashme me këtë, vetëm se për malazetët, e konstatoi Vlladimir Dvornikoviç, kur për mesazhet e njohura të Petrit I në të cilat ky lutet, për beton dhe mallkon malazetët që të heqin dorë nga gjakkarrja, konstatoi se secili prej tyre është „një dokument sociologjik dhe psikologjik”.<sup>38</sup> Meritojnë vëmendje observimet psikologjike në punimet e Dr. V. Çubrilloviçit, të Dr. M. Bajraktaroviçit dhe të Sreten Vukosavleviçit. Po kështu edhe ato të Dr. I. Jeliçit, të G. Gazemanit dhe të M. Šufflay-it. Me manirin e kuantifikimit të domosdoshëm të çdo gjëje (metodë që psikologjinë pothuajse e tjetërsoi nga jeta reale) kontributit të tyre në studimin psikologjik të gjakkarrjes, u muar vesh, mund t’i bëhen mjaft vërejtje. Për shkak të „scienticizmit” të këtillë me çdo kusht, psikologjisë i bënte vërejtje edhe vetë K. Marks.<sup>39</sup> Prezenca e tij në proces bashkëkohorë të kësaj shkence ende nuk është vërejtur mjaft, sepse kjo prezencë më shpesh mohohet me fjalët e njohura se ai kurrë nuk është marrë posaçërisht me psikologjinë, as që ka krijuar, pra,

<sup>36</sup> Dihet rezistenca që bënin malazetët kundër vënies së tatimeve. Përgjegjja e tyre: po të kishim dashur ta paguajmë, ne do t’ua jepnim turqve dhe nuk do të detyroheshim të luftonim kundër tyre 500 vjet.

<sup>37</sup> B. Popoviq, *Tipske slike rase*, në: *Autorët tonë dhe të huaj për Mark Milanin*, Grafički zavod, Titograd 1967.

<sup>38</sup> V. Dvornikoviç, *Karakterologjia Jugoslovena*, Geca Kon, Beograd 1939.

<sup>39</sup> „Psikologjia, për të cilën ai libër, pra pikërisht pjesa më prezente, më e përshtatshme në pikëpamje ndiesore e historisë, është i mbyllur, nuk mund të bëhet shkencë e njëmendët, me përmbajtje të pasur dhe reale”, K. Marks — F. Engels, *Rani radovi*, Naprijed, Zagreb 1967, f. 283.

çfarëdo teorie mbi personalitetin. Megjithkëtë nuk është vështirë të vërtetohet se Marksia ka qenë shumë më „psikologjik” se shumë psikologë mu sikundër që Frojdi ka qenë shumë më „sociologjik” se shumë sociologë. Për një vlerësim psikologjik bashkëkohor të gjakmarrjes ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe që t’u përgjigjemi këtyre pyetjeve: çfarë janë këto personalitete, cilat janë cilësitë e rëndësishme të tyre dhe pse sillen kështu? Cilat janë „rezonancat” psikologjike të tyre që u përgjigjen presioneve të caktuara të rrethit shoqëror? A janë qëndrimet e tyre një kopje e rëndomtë e formularëve të përcaktuar apo ka në këtë sjellje edhe njëfarë autonomiteti? Pse frika nga bojkotimi është më e fortë se dënimi fare i sigurtë? Përveç mundësive ekskluzivisht të veta të shpjegimit, psikologjia, në të kërkuarit e përgjegjes së këtyre pyetjeve, duhet t’i drejtohet për ndihmë etnologjisë dhe lëndës së saj, veçanërisht në pjesën që i referohet përcaktimit të sistemit të vlerave të këtyre njerëzve dhe zëvendësimit të këtij sistemi me një sistem që do t’i përgjigjej karakterit dhe ambicjeve të shoqërisë sonë. Me këtë rast nuk duhet eliminuar që më parë mundësinë e inkorporimit të caktuar të disa „pjesëve” të këtij sistemi në normat bashkëkohore të sjelljes (solidariteti, mikpritja dhe — pse jo? — respektimi i fjalës së dhënë). Kontributi i mundshëm i psikologjisë nuk kufizohet vetëm me kaq. Ajo mund t’i përgjigjet edhe pyetjes se a është kjo dukuri sjellje normale ose patologjike, gjë që nuk është pa rëndësi për „diagnozën” e saj shkencore, por edhe shoqërore, sepse nga kjo përgjegje varet në mënyrë më të drejtpërdrejtë politika shoqërore dhe ndëshkimore ndaj saj dhe, u muar vesh, ndaj njerëzve që e ndjekin.

### A është gjakmarrja sjellje normale ose patologjike

Gjakmarrja rëndom quhet sjellje tradicionale që në ditët tona ka humbur *raison d’être* të vet. Sipas këtij determinimi ekzistojnë së paku dy sjellje tradicionale: „e mirë” dhe „e keqe”. E vërteta është se ekziston edhe sjellja tradicionale turistike (ndërrimi i rojes para pallatit mbretëror në Londër ose pelerinazhi mbi varrin e Gjulietës në Veronë). Gjakmarrja sipas ndarjes së këtillë është, pra, sjellje „e keqe”. Mirëpo, këtu lihet pas dore rëndësia e relativitetit të sjelljes: dikur ajo ishte sjellje „e mirë”.<sup>40</sup> Me asnjërin nga këto etiketa nuk shpjegohet prezenca e saj në ditët, kur kjo dukuri „nuk duhet të ekzistonte më”.<sup>41</sup> Për shkak të mungesës së përmendur të punimeve sociologjike dhe psikologjike, kjo çështje ka qenë lënë pas dore. Atje ku është shqyrtuar kjo nuk është bërë kurdoherë si duhet, kështu që kjo dukuri, dhe njerëzit bashkë me të, ngarkohen me veti që nuk i përgjigjen gjakmarrjes. Mu për këtë kjo dukuri, në një simpozium mbi dukuritë sociale-patologjike në shoqërinë tonë, u gjend tok me prostitutet, narkomanët dhe alkoolistët,<sup>42</sup> ndonëse me

<sup>40</sup> Këtë e kishte parasysh S. Vukosavljeviq kur shkroi se „gjakmarrja nuk ishte aq e përgjakshme sa na duket tani neve”. (op cit., 75). Kështu mendon Dr. M. Barjaktareviq: „Pjesëtarit të fisit, i cili si edhe ne, ka vetëm një jetë, ajo (gjakmarrja) nuk i duket aq e tmershme” (op, cit., 116).

<sup>41</sup> M. Karan, *Psihološka priroda krvne osvete*, Jugoslovenska revija za kriminalologiju i krivično pravo, Beograd 1971, nr. 4.

<sup>42</sup> *Društvena patologija u Jugoslaviji*, Materialet e simposiumit në Vërnjačka Banja, Institut za kriminaloška i kriminalistička istraživanja, Beograd 1969.

siguri nuk e ka vendin në një shoqëri të këtillë. Nuk e ka për shkak se për shumë gjëra u shmanget „kandarëve” me të cilët zakonisht matet karakteri normal, respektivisht jonormal (social) i një dukurie. Lënda etnologjike (dhe dokumentacioni psikologjik po ashtu) eliminon vlerën e „diagnozës” së përcaktuar në këtë mënyrë. E vërteta është se gjakmarrja sot nuk është sjellje normale, por nuk është as sjellje patologjike. Ajo është dukuri sui generis dhe si e tillë duhet të shqyrtohet.<sup>43</sup> Na merr mendja se shpjegimi psikoanalitik, përveç atij psikologjik, disa „hollësi” mund t’i shpjegojë më mirë dhe më thellësisht. Ky shpjegim mund të fillojë me traditën mbi stërgjyshin e përbashkët (krahaso mësimin e Frojdit mbi krijimin e shoqërisë njerëzore dhe veçanërisht të gostisë totem), pastaj me dinamizmet psikologjike të formimit të grupit (zgjedhja e prisit dhe identifikimi) dhe së fundi me shpjegimin e tij të kimit, në prapavijën e të cilit ndodhet sentiment i fajit. Për një qëllim të këtillë gjakmarrja është objekt „natyror” i gjurmimit: me aktin e hakmarrjes familja e hakmarrësit, dhe ai po ashtu, janë viktimë potenciale e veprimit të vet, meqë tani atyre u kanoset hakmarrja. Ç’është, pra, familja e këtillë: viktimë ose kriminel ose edhe njëra edhe tjetra njëkohësisht? Ndonëse nuk qe nisur me qëllime të këtilla, J. Ramadanović arriti pikërisht në një pyetje të këtillë: familjet që janë në grindje sakatojnë njëra-tjetrën, largohen, por edhe tërheqin njëra-tjetrën — diçka e ngjashme me luftën e mungosits e të gjarpërit. Mu për këtë çdo krahasim i thjeshtësuar është përgjysmë i pasaktë, sepse nuk mund të thuhet zi: ekzekutuesi, kurse bardhë: viktimia.<sup>44</sup> Puna e vërtetë për shpjegimin e „pjesëve” thellësore të gjakmarrjes, pra, sapo pritet, meqë shumica e punimeve të gjertanishme kryesisht përqëndroheshin në tiparet „sipërfaqësore” (të dukshme), gjë që nuk mjafton për të shpjeguar prezencën e saj në ditët tona. Këto shpjegime janë edhe më të pamjaftueshme për eliminimin e paragjykimeve të tjera mbi këtë dukuri, ndonëse pikërisht kjo është një nga detyrat paraprake të çdo studimi mbi gjakmarrjen.

### A është gjakmarrja dukuri „e importit”, respektivisht e „eksportit”

Historianët e shoqërisë njerëzore, së paku shumica, konsiderojnë se gjakmarrja është dukuri e ligjshme në një shkallë të caktuar të zhvillimit të saj. Kjo shkallë përbëhet nga bashkësitë fisnore dhe, u muar vesh, nga niveli i njohur i produktivitetit, respektivisht i ndarjes së punës. Me shturjen e organizatave të para, u zhdukën edhe arsyet e ekzistimit të mëtejshëm të saj — së paku në pjesën më të madhe të botës. Fakti se ajo ende u ruajt në disa vise sikur u shkon për shtati spekulimeve kinëse për „importin”, respektivisht „eksportin” e gjakmarrjes nga një vend në tjetrin. Kjo më shpesh provohet me migrimet dhe përgjasimet përkatëse. Mirëpo, përgjasimet (po qe se ekzistojnë) nuk lindën për shkak të „importimit” të kësaj dukurie, por për shkak të kushteve të ngjashme të jetës dhe nivelit pothuajse të njëjtë të zhvillimit, respektivisht të prezencës relativisht ende të madhe të „bagazhit” zakonor. Ku ekziston

<sup>43</sup> M. K a r a n, *Krvna osveta: „patološko” ili „normalno” ponašanje*, Sociologija, Beograd 1973, nr. 1.

<sup>44</sup> J. R a m a d a n o v i ć, *Krvna osveta kao dualistika jedinstva suprotnosti*, 13 Maj, Beograd 1971, nr. 10.

tjetër gjakmarrja? Në Evropë ajo ekziston në Sicili, Korzikë, Jugosllavi (kryesisht Krahina e Kosovës), viset e Kavkazit në Bashkimin Sovjetik dhe, ndoshta, në Mainë të Peloponezit (Greqi). Të gjitha këto vise kanë shenja të përbashkëta që nuk është vështirë të gjenden. Këto karakteristika janë përgjegjëse që u ruajt kjo dukuri e jo eksporti i presupozuar. Nuk janë pjesëtarët e fisit Kuç malazez që e „bartën” këtë dukuri ndër pjesëtarët e fisit Kuç shqiptar — ose anasjelltas — por shekuj me radhë ata jetuan në rrethana të njëjta ose shumë të ngjashme. Këto kushte banë që të lindë dhe të ruhet gjakmarrja në të dy këto fise. Po të mos ishte kështu, si mund të shpjegohej fakti se gjakmarrje nuk kishte ndër toskët (në Shqipërinë e Jugut) ose në Greqi, ku në fillim të këtij shekulli jetonin afër 200.000 shqiptarë?<sup>45</sup> Pse nuk kishte në garnizonet turke, ndonëse në to patjetër do të ketë pasur mjaft shqiptarë?<sup>46</sup> Pse, më në fund, nuk ekziston në popullsinë serbe në Kosovë, ndonëse shekuj me radhë jetojnë bashkë me shqiptarët? Në bisht të paragjyimit mbi „importimin” e gjakmarrjes ra madje edhe princ Milloshi, kur u dha urdhër të prerë autoriteteve të pushtetit në viset perëndimore të Serbisë së atëhershme (në vitin 1921) që „të mos lejojnë kurrësi hakmarrje sipas zakonit shqiptar”. Mirëpo, në rrethanat politike, ekonomike dhe kulturore të Serbisë së atëhershme nuk ka mundur të ekzistojë gjakmarrja. Princ Milloshi, pra, ka mundur edhe të mos e dërgojë urdhërin e përmendur.

### Kualifikimi juridik i gjakmarrjes

E drejta e shtetit fare pak u kushtonte kujdes rregullave juridike zakonore të sjelljes. Tek e mbramja, çdo akt juridik ishte më tepër sjellje e dëshiruar se sa sjellje reale. Mu pse kurdoherë ekziston diçka para asaj së cilës i referohet çdo ligj i posanxjerrë ka divergjencë të caktuar me veprimet e atyre me të cilët ka të bëjë. Kjo „mosmarrëveshje” është edhe më e dukshme në ngjarjet revolucionare të cilat, ngase duhet të jenë të reja, me vendosmëri — ngandonjëherë në mënyrë të ngathtë ose edhe të vrazhdët — përcaktojnë një rregullore të sjelljes që i përgjigjet programit të ri politik dhe social. Këto gjëra të reja i ngut avangarda shoqërore dhe këtu qëndron rëndësia historike e saj. „Pjesa tjetër” e njerëzve nuk i ndjekin këto gjëra të reja me shpejtësi të njëjtë, as me gatishmëri të njëjtë poashtu. Prandaj, „mosmarrëveshjen” në fjalë duhet shpjeguar njerëzve së paku aq sa u shpjegohet përparësia e traktorit ndaj përmendës ose arsyeshmëria e shkuarjes te mjeku dhe jo te hoxha, respektivisht te prifti. Me këtë rast ka rëndësi të veçantë t’u tregohet njerëzve se ligji nuk është „i butë” pse ligjdhënësit janë njerëz „zëmërbutë”, por është i tillë për shkak të politikës së përgjithshme të shoqërisë që represalien don ta kufizojë në masën më të vogël. Dija e këtillë, respektivisht një vetëdije e këtillë juridike ende nuk ekziston në disa vise, andaj kualifikimi „zyrtar” dhe „popullor” i sjelljes së njëjtë është në divergjencë të konsiderueshme. Kjo shihet më së miri nga zgjidhja ligjore ose juridike-zakonore e veprës penale kundër fyerjes së nderit, për të

<sup>45</sup> Dr. J. Rexhepagiq, *Etniçke promene Albanaca u XVII i XVIII stoleću*, Akademija nauka i umjetnosti Bosne i Hercegovine, Godišnjak, libri VI, Centar za balkanološka ispitivanja, libri 4, Sarajevo 1968.

<sup>46</sup> Sipas kumtimit personal të Dr. H. Kaleshit, profesor i Universitetit të Prishtinës.

cilën Kodi ynë penal parasheh gjobën ose dënimin me burgim deri në gjashtë muaj. Për po këtë veprim Kanuni i Lekë Dukagjinit parasheh vetëm dy mundësi: hakmarrjen (kokën) ose faljen.<sup>47</sup> As kualifikimi i gjakmarrjes nuk iu shmang kësaj „mosmarrëveshjeje”. Në Kodin tonë penal ajo u kualifikua si vrasje „nga motivet e ulta” (neni 135, al. 2 pika 3 i KP). Kualifikimit të përmendur mund t’i bëhet vërejtja se ai është „statik”, meqë vrasja për gjakmarrje mëshpesh nuk është nga motivet e ulta (ndonëse mund të jetë edhe e paskrupullt), por është botëkuptim „i shtrembëruar” (jobashkëkohor) mbi nderin. Prandaj nuk është gjë e rastit që njohësit e respektuar të kësaj dukurie, madje edhe ndër juristët, me plot prova argumentojnë se vrasja për gjakmarrje nuk është e thënë se patjetër duhet të shpjegohet me motivacionin e përmendur.<sup>48</sup> Nuk duhet për shkak se kjo sjellje dallohet nga vrasja e një gangsteri ose cubi, mu sikurse dallohet një mjek laik që beson se magjtitë e tij shërojnë dhe një hohshtapler që di se këto janë dokrra, por megjithkëtë i bën.<sup>49</sup> Kualifikimi i përmendur, ç’është e vërteta, nuk do të thotë se çdo vrasje për gjakmarrje patjetër vlerësohet si hakmarrje e paskrupullt. Që të jetë e këtillë ajo duhet të ketë cilësi rënduese, siç janë hakmarrja ndaj njerëzve të pafajshëm ose hakmarrja në të cilën motivi është në disproporcion të madh me lëndimin që hakmerret (për shembull, vrasja për shkak të fyerjes).<sup>50</sup> Këtij vlerësimi duhet t’i shtohen së paku edhe dy kushte: vrasja e fëmijëve dhe vrasja e pleqve ose madje paraqitja e rreme e të miturve si vrasës, ndonëse ata padyshim nuk janë. Nuk janë pa arsye edhe propozimet që të përgjigjet penalisht edhe i zoti i shtëpisë sepse dihet se pa lejen e tij hakmarrja është gjë e pamundur. Sidoqoftë, është fakt se në literaturën tonë ka pak punime që trajtojnë këtë „mosmarrëveshje” midis botëkuptimit ligjor dhe atij juridik zakonor mbi gjakmarrjen. Kodi penal i Krahinës së Kosovës, që së shpejti do të nxirret, duhet t’i kushtojë kujdes kësaj masmarrëveshjeje. Lënda etnologjike, veçanërisht ajo shqiptare, në këtë rast nuk duhet të trajtohej sikur nuk ekziston sepse, në qoftë se më vonë del se ligji është joadekuat do të ketë pak mundësi që të nxirret ligji i ri.

### Në vend të konkluzionit: nevojiten punime të reja

Kontributi etnologjik studimit të gjakmarrjes në Ballkanin qendror, tani e dimë, nuk është vërejtur në mënyrë të duhur. Nuk është vërejtur për shkak se ky kontribut më shpesh është vlerësuar si faktografi e mërëseardhur

<sup>47</sup> Sipas Kanunit të Lekës Dukagjinit „Ndera e marrun nuk shpërblehet me gjâ, por a me të derdhun të gjakut a me të falun fisnikisht (përmbas ndermjetsis së dashamirve të mirë)”. (§ 598). Paragrafi 600 i po këtij Kanuni përcakton shprehimisht se „Aj të cilit i u muer ndera, xëhet i dekun kah kanûja”.

<sup>48</sup> „Ai që bën vrasje për hakmarrje subjektivisht kurrë nuk mendon se ka bërë një vepër të turpshme ose të ulët. Ai është i vetëdijshëm se po bën një vepër të rëndë, por është i bindur se është duke bërë një vepër që pranohet dhe lejohet nga rrethi i tij”. Lidhur me këtë shih: R. Vranjqi, *Krivično-pravni aspekt krvne osvete na Kosovu*, Jugoslovenska revija za kriminalogiju i krivično pravo, Beograd 1971, nr. 4. Po kështu D. Moračić, *O nekim krivično pravim i drugim pitanjima u vezi sa krvnom osveto*, Obeležja, Prishtinë 1971, nr. 2, ky autor përcakton „se personat që bëjnë vrasje për hakmarrje të shumtën nuk janë të prirur për kriminalitet dhe se vendosin të bëjnë krim nën presionin e rrethit dhe të rregullave zakonore”. Kontribut të rëndësishëm për përcaktimin e psikologjisë së kryesve të veprave penale të gjakmarrjes ka dhënë Dr. V. Pešić në studimin e tij „Ubistva u Jugoslaviji”, Institut za kriminološka i sociološka istraživanja, Beograd 1972.

<sup>49</sup> M. Karan, *Psihološka priroda krvne osvete*, 624.

<sup>50</sup> Dr. B. Zlatarić, *Kada dolazi u obzir kvalifikacija ubojstva iz bezobzirne osvete po članu 135, stav 3. toč. 3. KZ*, Jugoslovenska revija za kriminologiju i krivično pravo, Beograd 1973, nr. 4.

e së ashtuquajturës jetë popullore. Me atë rast, nga mosdija ose nga ndonjë motiv tjetër, nuk përfilllet fakti se kjo „faktografi” në pjesën e rëndësishme të saj është një studim sociologjik dhe psikologjik i shprehive të njerëzve për të cilët bëhet fjalë në këto materiale. Mungesa e punimeve sociologjike dhe psikologjike në këtë studim padyshim i ka kontribuar deri diku gjendjes në të cilën ne i dimë mirë zakonet dhe sjelljet e trobrianderëve diku në ujdhesat e Oqeanisë së largët, e nuk i dimë, ose i dimë pak, njerëzit që jetojnë me ne dhe rreth nesh. Ky punim angazhohet për një prezencë më të madhe të këtyre shkencave në studimin e dukurive që deri tani vonë ishin „ngarkim” pothuajse ekskluziv i etnologjisë. Ja, pa ndonjë radhitje të posaçme, çështjet e mundshme për psikologjinë etnologjike (dhe sociologjinë etnologjike po ashtu): urdhërat e dervishëve dhe ceremonitë e tyre, shtojzavallet në fshatin tonë, faltoret si „vendshërimi”, mbajtja e hajmalive, institucioni i vojvodëve të manastireve në Kosovë, puna e bashkuar dhe solidariteti në fshatin tonë, etj. Shkenca, ç’është e vërteta, nuk njeh kufij kombëtarë, por as e ashtuquajtura shkencë botërore, nuk ekziston vetë për vete: ajo është një tërësi dijesh të shkencave kombëtare dhe të kontributit të tyre trashëgimit kulturor të njerëzimit. Etnologjia jonë, në kohën e vet, i dha kontribut të rëndësishëm kësaj shkence. Kontribut më të vogël dhanë sociologjia dhe psikologjia. Mospërfillja e caktuar e së kaluarës, e së kaluarës sonë dhe shpeshherë një manir prej ronxhobonxhoje që me çdo kusht të mbahet hapi me shkencën botërore — janë disa nga arsyt e kësaj prapambetjeje sa i përket studimit të zakoneve e të sjelljeve të njerëzve tanë dhe të sistemit të tyre të vlerave. Çdo shkëmbim i dijes shkencore është i mirëseardhur, por është edhe më mirë kur kjo nuk bëhet në një drejtim. Mirëpo, në shkencën tonë ende ka aty-këtu diçka nga mentaliteti „provincial”, kështu që ngandonjëherë meren botëkuptime të huaja që sigurisht janë të sakta për merren si shpjegim për ndonjë dukuri tonë. Si mundet që me një shembull, nga e ashtuquajtura tendencë interaksioniste në kriminologjinë bashkëkohore të shpjegojmë kriminalitetin tonë, duke përfshirë këtu edhe gjakmarrjen? Si mundet, që me shembull të dytë, botëkuptimi kaq të preferuar (dhe të pacaktuar!) mbi tjetërsimin e njeriut të shpjegojmë këtë dukuri—sot dhe këtu? Ky punim, pra, është diçka si kontribut studimeve tona të të ashtuquajturës jetë popullore — këtë herë vetëm sa i përket çështjes së gjakmarrjes në Ballkanin qendror.

*Milenko Karan*

ASPECTS SOCIOLOGIQUES ET PSYCHOLOGIQUES  
DE L'ETUDE ETHNOLOGIQUE DE LA VENDETTA DANS LA REGION  
DES BALKANS CENTRAUX

R é s u m é

Les raisons qui expliquent le présent sujet sont les commencements des recherches interdisciplinaires de la vendetta au Kosovë (Yougoslavie). Il faut mentionner l'importance et l'utilisation directe des connaissances ethnologiques de ce phénomène dans les Balkans

centraux. Ces connaissances étaient négligées à tort car on les considérait comme un fait ordinaire de la vie populaire; et de plus elle n'avait pas assez de particularités scientifiques. Le présent travail tente de constater une telle attitude au moyen de la psychologie ethnologique. Les matériaux ethnologiques confirment la supposition qu'il existe une importante documentation sociologique et psychologique bien appropriée pour l'étude contemporaine de la vendetta. Pour les besoins du présent sujet on a été obligé de faire une sélection respectueuse de ces matériaux.

Dans ce sens, on a étudié en particulier les aspects sociologiques et psychologiques des connaissances ethnologiques des phénomènes liés à cette question: la tribu et ses normes de comportement, création d'un système de valeurs, l'individu et le groupe auquel il se réfère, la vendetta comme solidarité primaire, „le milieu” sociologique de la vengeance, „les aspects” psychologiques, „la normalité” ainsi que „l'anomalie” de ce comportement, quelques préjugés sur ce phénomène et la réglementation juridique de la vendetta. En étudiant ces questions, on conclut que la vendetta était (jadis) un phénomène légal qui a presque disparu de nos jours. Là, où elle subsiste, la cause n'en est pas les qualités supposées des gens („le sang vif” ou „l'agressivité innée”) mais les conditions déterminées socio-économiques et culturelles. Pour cela on ne peut pas dire que la vendetta est un comportement socio-pathologique. Si on la considère comme comportement anachronique la vendetta est un phénomène *sui generis* est c'est ainsi qu'il faut l'étudier. On dit que la réglementation juridique de ce phénomène ne correspond pas non plus à son caractère réel et c'est pourquoi il existe toujours un certain „malentendu” entre la conception du droit coutumier et celle de l'état, surtout en ce qui concerne les motifs de ce comportement. Pour mieux comprendre la vendetta, la sociologie et la psychologie sont nécessaires parce qu'on les avait négligées dans l'étude antérieure. Dans ce but aucune de ces sciences ne peut laisser de côté les matériaux ethnologiques antérieurs concernant la vendetta. Le présent sujet, en quelques mots, n'est qu'une initiation pour une étude plus large et plus rationnelle des matériaux ethnologiques — cette fois-ci uniquement dans le domaine concernant les aspects sociologiques et psychologiques de l'étude ethnologique de la vendetta dans les Balkans centraux.